

AGJENCIA KOMBËTARE E
PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
Nr. 306P Prot.
Datë, më 14.09.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME TEKNIKE PROFESIONALE "DEMIR PROGRI" KORÇË

Nr. 122 Prot.

Korçë, më 09/09/2021

Lënda: Njoftim për levizje paralele.


Drejtuar: Drejtorisë Qëndrore të AKPA-së.
Tiranë.

Në shkollën e mesme teknike profesionale "Demir Progri" Korçë, për arsye të mbushjes së moshës për pension, krijohet 1 (një) vend i lirë për pozicionin:

- Mësimdhënës i praktikës profesionale në drejtimin Mekanikë.

Faleminderit për bashkëpunimin!

Paskal Caca



REPUBLICA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME TEKNIKE PROFESIONALE "DEMIR PROGRI" KORÇË

Nr. 22/4 Prot.

Korçë, më 09/09/2021

Lënda: Njoftim për levizje paralele.

**DREJTORISE SE SHERBIMEVE MBESHTETESE
DREJTORISE SE MARREDHENIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISE KOMBETARE TE PUNESIMIT DHE AFTESIVE**

Në zbatim të ligjit nr.15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, " Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019, " Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive"; të udhëzimit nr.14, datë 27.05.2021, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional",

Ofruesi publik i AFP-së shkolla e mesme teknike profesionale " Demir Progri" Korçë, ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin:

- Mësimdhënës i praktikës profesionale në drejtimin Mekanikë.

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- a) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) Të jetë në kushte shëndetsore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) Të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) Të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) Të ketë të paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale në të njëjtën fushë me kualifikimin profesional të ofruesit të AFP-së për të cilin po aplikon.
- b) Të ketë të paktën 3(tre) vjet përvojë pune në fushën , në të cilën ka kryer studimet.
- c) Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

2. Dokumentet e aplikimit.

Dosja e aplikimit e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) - Letër motivimin për pozicionin;
- b) - Jetëshkrimin (CV-në)
- c) - Kartën e identitetit
- d) - Diplomën
- e) - Librezën e punës
- f) - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV.
- g) - Certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit.
- h) - Vërtetimin e gjendjes shëndetsore
- i) - Vërtetimin e gjendjes gjyqësore.
- j) - Vërtetim nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marre masë disiplinore në fuqi të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brenda datës 22.09.2021

DREJTOR
Paskal Çoka

